

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Raima Elezi si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Nazim Vllaqo dhe Alia Fazliji si anëtarë, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. Q. nga Dragashi, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 e lidhur me nenin 28 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr. 66/16 të datës 04.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. B. B. nga Prizreni, me datë 06.12.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F. Q. me nofkën “d. M.”, nga i ati N. dhe e ëma Sh., e lindur S., i lindur me datë ... në Dragash, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i papunësuar, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, ka qenë në paraburgim prej datës 10.03.2016 deri më datën 12.07.2016 dhe nën masën e arrestit shtëpiak deri më datën 16.08.2016.

Konform nenit 364 par.1 nënpar 1.3 të KPP

LIROHET NGA AKUZA

Se me datë 25.12.2016 rreth orës 17:00 në Dragash, me dashje eventuale tenton të privoj nga jeta personin tjetër në atë mënyrë që në afërsi të kafeterië “T.” derisa i dëmtuari E. S. nga fshati ... Komuna e Dragashit ishte duke pritur kolegun e tij të punës, rreshterin e policisë M. A. i akuzuari i pajisur me një thikë i përvidhet nga pas dhe e godet të njëjtin tri herë në shpinë, në pjesën e pasme të krahavorit duke i shkaktuar tri plagë prerëse dhe shpuese në regjionin e shpinës në të dy anët e hematoraksit.

- këso dore do të kishte kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me neni 28 të KP-së.

I dëmtuari E. S. për realizimin e kërkesës pronësoreshë juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzës PP.nr. 66/16 të datës 04.05.2016 kundër të akuzuarit F. Q. nga Dragashi, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP-së.

Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të provave të administruara me dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat materiale është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e aktakuzës, duke shtuar se nëse i referohemi dëshmisë së dëmtuarit E. S. të dhënë në polici, pranë prokurorisë dhe në shqyrtimin kryesor, është vërtetuar se i njëjti është

goditur me thikë nga ana e të akuzuarit. Nga dëshmia e dëshmitares E. B. e cila ka treguar mbarëvajtjen e hetimit si policë hetues lidhur me hartografin dhe hyrje-daljeve të telefonatave të të akuzuarit dhe të dëmtuarit, është vërtetuar se gjendja faktike e gjetur në telefonata dhe hartografi nuk përputhet me deklaratën në të cilën i akuzuari thotë se ka qenë në vend jo afër vendit të ngjarjes, por para se të ndodhë ngjarja ka qenë në restorantin “Meka”, ndërsa nga kamerat e sigurisë policia ka vërtetuar se ai në atë moment nuk ka qenë në atë restorant. Në deklaratën e tij për kohën kur është kryer vepra penale ka deklaruar se fillimisht ka qenë në shtëpi e pastaj ka shkuar për t’i shëtitur qentë por nga hyrje-daljet e telefonatave dhe hartografia rezulton që F. Q. në momentin kritik prej orës 16:47 minuta ka bërë telefonata nga vendi i cili u zbulon nga antena G3, nga vendi i njëjtë ku ka qenë edhe i dëmtuari dhe ku ka ndodhur ngjarja, nga kjo provë vërtetohet se në momentin kritik edhe i dëmtuari ka qenë në vend i cili zbulohet nga antena G3, po të ishte në atë kohë i akuzuari në shtëpi telefonata e tij do të evidentohet nga vendi që mbulon antena “Bukiqi G3”, kjo antenë zbulon edhe vendin ku gjendet shtëpia e të akuzuarit. Sa i përket dashjes konsideron se në këtë rast i akuzuari ka vepruar me dashje eventuale, pra vendimi për të ndërmarr një veprim të tillë ka qenë pa një motiv nga më herët dhe pa u planifikuar më parë, andaj konsideron se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet. Propozon që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimit propozon që gjykata të marrë parasysh se i dëmtuari nuk paraqet interesimin për ndjekjen e të akuzuarit, raportet e rregulluara në mes tyre, mungesën e pasojave dhe moshën e re, ndërsa si rrethana rënduese faktin se i akuzuari disa herë ka qenë përgjegjës dhe shpallur fajtor për veprat penale që bëjnë pjesë në grupin e veprave kundër jetës dhe trupit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. B. B. në fjalën përfundimtare ka theksuar se duke u bazuar në provat e administruara konsideron se aktakuza kundër të mbrojturit të saj nuk është vërtetuar, është e njëanshme duke lënë anash mendimet, deklaratimet e dëshmitarëve e aq më tepër dëshminë e vet e të dëmtuarit E. S. I mbrojturi i saj ka mohuar kryerjen e veprës penale duke deklaruar se ditën kritike nuk ka qenë në vendin e ngjarjes e as më pak të ketë kryer veprën penale pasi që raportet me të dëmtuarin kanë qenë të mira dhe asnjëherë nuk kanë pasur as më të voglin konflikt, të cilën fakt nuk ka mohuar as vetë i dëmtuari i cili fakt vërtetohet edhe me dëshmitë e dëshmitarëve A. M., Sh. K., H. D., M. A. dhe R. O., të cilit kanë dëshmuar se ditën kritike nuk kanë parë të mbrojturin e saj e as që kanë ditur për veprën penale të ngelur në tentativë se kush e ka kryer. Propozon që në bazë të neni 364 par. 1 pik. 1.3 të KPP, gjykata të marrë aktgjykim liruës.

I akuzuari F. Q. duke mohuar kryerjen e veprës penale në mbrojtjen e vet ka theksuar se i kujtohet se ditën kritike diku në ora 10:00 ka dalë në Dragash për të shëtitur me djalën e mixhës B. Q., i cili jeton në Dragash dhe janë takuar me disa shokë. Pastaj vet ka shkuar në restorantin “M.” ku ka qëndruar përafërsisht 30 minuta, nga ka shkuar në kafeteri “M.” ku si kamarier ka punuar personi me emrin A. dhe është shërbyer me kupon fiskal. Prej aty ka shkuar në shtëpi dhe diku në ora 14:00 ka marrë qentë, në atë kohë kishte tre qen dhe ka dalë ti shëtisë në rrugë e cila qon për në rrugën R. tek vendi i quajtur “p. “mbi shtëpi të tij, çdo ditë ka vepruar në të njëjtën mënyrë duke shëtitur qentë 4 – 5 orë në ditë. Ka qenë i veshur me jelek ngjyrë të bardhë, përmbi ka pasur një xhemper të zi me kapuç dhe me ato tesha ka shkuar edhe në polici. Ka shëtitur deri në moment kur ka pranuar një thirrje telefonike nga babai i cili e ka lajmëruar që e kërkon policia. Nuk i kujtohet sa ka qenë ora por e din se ka qenë mbrëmje kur është kthyer në shtëpi, vetëm i ka zbatuar çizmet, i ka lanë qentë dhe ka shkuar, meqë patrulla e cila e ka kërkuar në shtëpi nuk ka qenë prezent, ai menjëherë ka shkuar në stacionin policor për të parë pse e kanë kërkuar. Të dëmtuarin E. S. e njeh prej femërisë, e njeh si polic dhe kanë pasur raportet e mira, ditën kritike nuk e ka takuar E. dhe

nuk ka kryer veprën penale ndaj tij. E din ku gjendet kafeteri “T.” është e vërtet që ka pasur disa raste në polici por kjo ka ndodhur në kohën kur ka qenë i mitur .

Gjatë shqyrtimit kryesor janë lexuar provat materiale dhe atë :

-akt ekspertimi mjekoligjor, i punuar nga dr. M. G. në bazë të dokumenteve të çështjes për të dëmtuarin E. S., nga i cili vërtetohet se i dëmtuari ka pësuar plagë therëse në regjionin e shpinës hemotoraks në të dy anët dhe plagë therëse në të dy shuplakat e duarve, të cilat lëndime bëjnë pjesë në dëmtimet e rëndë trupore. Gjatë shqyrtimit kryesor dr. M. G. ka precizuar akt ekspertimin duke deklaruar se pas shikimit edhe një herë në detajet e raportit, në rastin e deshifrimit të diagnozave për të dëmtuarin E. S. ka ndodhur gabimi teknik ku në vend të “pulmo” që do të thotë mushkëri është deshifruar si “palma” që do të thotë shuplaka e dorës, andaj tërhiqet fjala se kemi të bëjmë me dëmtime në shuplakë të duarve dhe deklarom se i dëmtuari E. S. ka pësuar plagë prerëse, shpuese në pjesën e sipërme të shpinës me hemotoraks në të dy anët e kafazit të krahërorit si dhe plagë prerëse në të dy mushkëri, të cilat dëmtime janë të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të prehtë (me maje e teh) dhe si të tilla janë dëmtimet të rënda trupore.

- raporti i Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash nr. ... të datës 25.12.2015 nga e cila vërtetohet se i dëmtuari E. S. është sjellë në QKM në Dragash në ora 17:30 minuta i orientuar në kohë dhe hapësirë .

-raporti i Qendrës Emergjence i spitalit Rajonal në Prizren me nr. ... të datës 25.12.2015, ku konstatohet diagnoza “vulnera scisso punctum reg. Dorsi pars sup, hematohtorak bill . Obs. Vulnera scissum pulma bill”, transferohet në QKUK – kirurgji torakale.

- informacioni e zyrës ZKL nr. 273/16 së bashku me hartografinë .

- informacioni të telefonit të Kosovës ZKL nr. 123/16 të datës 25.01.2016.

- raporti mjekësor me nr. ... të datës 25.12.2015 në ora 20:20 minuta nga i cili vërtetohet se nga një patrullë e policisë të Kosovës sillet si pacient në QKMF Dragash A. V. M. , nga fshati ..., pacienti është i orientuar në kohë dhe hapësirë, në gishtin e mesit (III) të dorës të djathtë, në pjesën e sipërme vërehet një gërvishtje 2-3mm.

- raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, dosja forenzikës TK 129-2015, të datës 25.12.2015 në ora 17:15, minuta nga i cili vërtetohet se vendi i ngjarjes gjendet në hyrje të Dragashit, përballë stacionit të autobusëve, para kafeterisë “T.”.

Gjatë shikimit të vendit të ngjarjes policët e teknikut kriminalistik së bashku me policët hetues kanë bërë kontrollimin e vendit të ngjarjes me qëllim të gjetjes të ndonjë dëshmie që lidhet me rastin, por nuk është gjetur asnjë dëshmi. Rreth orës 21:10 minuta është bërë kontrollimi dhe fotografimi i automjetit “Audi” me targa xx-xxx xx ngjyrë hiri metalike pronë e të dyshuarit M. A., i cili ka qenë i parkuar në oborrin e stacionit policor Dragash por gjatë kontrollimit nuk është gjetur asgjë e dyshimtë. Në atë kohë i dyshuari M. A. është fotografuar në korridorin e stacionit policor në Dragash. Pastaj është bërë kontrollimi i automjetit “Golf 2”, ngjyrë të kuqe, me tabela xx-xxx- xx pronë e policit M. A. ku në pjesën e epërme të mbështetëses të ulëses së pasagjerit në anën e djathtë është zbuluar një materie me ngjyrë të kuqe që dyshohet të jetë gjak evidentuar me nr. 1. Në bagazhin e automjetit të

policisë të tipit “Nisan Terrano”, me tabela xxx-xx ngjyrë të kaltër të mbyllët, është marrë një xhakete e viktimës me ngjyrë të zezë dhe të kaftë, e cila është fotografuar dhe evidentuar me dëshmi nr. 2. Gjatë fotografimit janë zbuluar dy dëmtime “prerje” që dyshohet se janë shkaktuar nga ndonjë mjetë i preftë, në pjesën e shpinës të cilat janë evidentuar me nr. dëshmi 2.1 dhe 2.2 .

Nga foto albumi ne numër të dosjes TK 129-2015 të datës 25.12.2015, shihet pamja e vendit të ngjarjes në afërsi të kafeterisë “T.” në Dragash, përballë stacionit të autobusëve, ku dyshohet se ka ndodhur lëndimi i rëndë trupor i viktimës, shihet hyrja në kafeterinë “T.” ku kanë qenë duke ndenjur viktima para se të ndodh rasti, shihet automjeti “Audi” në të gjitha anët e tij, pronë e, në atë kohë të dyshuarit e mundshëm A. M., si dhe dokumentacioni, fotografia e të dyshuarit e mundshëm A. M. i lindur me datën ... në Dragash, nga e cila vërtetohet se i njëjti ka qenë i veshur në pjesën e sipërme me xhemper ngjyrë bardhë dhe jakne të lëkurës me ngjyrë të zezë, si dhe automjeti “Golf 2 “ me ngjyrë të kuqe me targa xxx-xx- xxx xx dhe pjesa e karriges në të cilën gjendet materia ngjyrë të kuqe që dyshohet të jetë gjak , pronë e M. A. si dhe automjeti “Nisan” me targa police xxx-xx në të cilën shihet xhaketa e viktimës dhe xhaketa me ngjyrë të zezë e cila kishte dy dëmtime në pjesën e prapme në mes të dy krahëve .

Gjykata në bazë të provave të administruara ka vërtetuar se nuk është kontestuese se ditën kritike i dëmtuari E. S., rreth orës 14:00 ka qenë në Dragash ku ka qëndruar pakë kohë te një mikë i tij në një lokal, pastaj ka shkuar në kafeterin “T. “ ku është takuar me kolegët M. A. dhe R. O., bashkë kanë pirë disa bira dhe aty ka mbetur deri diku rreth ora 17:00. Meqë nuk e kishte me vete veturën, prej kolegut M. kërkoi që të dërgojë në shtëpi, ashtu që së pari nga kafeteria ka dalë M. dhe ka shkuar deri te vendi ku e kishte të parkuar veturën diku në largësi prej 10 metra dhe është afruar te kafeteria, pas tij ka dalë edhe i dëmtuari dhe në momentin kur është nisur në drejtim të vendit ku është afruar M., papritmas është therrur në pjesën e shpinës. Ka ndier një dhimbje por atë nuk ka mund të definonte si therrje por si njëfarë goditje në shpinë me dorë, e cila i ngjante si një lloj përshëndetjeje në mes miqëve kur zakonisht njeri tjetrin e godasin me dorë në shpinë në shenjë përshëndje. Pasi ka shkuar tek mjeku ka kuptuar se në të vërtetë në shpinë ka pësuar lëndime në formë të therrjeve – plagë shpuese. Po ashtu është jo kontestuese se i akuzuari F. Q. dhe i dëmtuari E. S. njihen mirë dhe në fakt ata jetojnë në fqinjësi. I dëmtuari përndryshe është zëvendës komandanti pranë Stacionit policor në Dragash, ku i akuzuari është i njohur si person i cili ka prirje për konflikte, mirëpo ndonjë mosmarëveshje në mes tyre nuk ka pasur. Ditën kritike i akuzuari është parë nëpër Dragash, madje edhe i dëmtuari e ka parë të njëjtin me disa shokë diku në ora 13:00.

Këto fakte gjykata ka vërtetuar në bazë të deklaratave të dëmtuarit, deklaratës së dëshmitarëve M. A., R. O., E. B., Sh. K. dhe A. M. si dhe në bazë të provave materiale si ekspertiza mjekoligjore dhe raportet e PTK-së.

Duke pasur parasysh se gjykata i vërteton faktet në bazë të provave dhe një provë është provë vetëm atëherë ku na bind se diçka është e vërtetë, se diçka është e dëshmuar, kur ajo provë ka fuqinë provuese dhe kur vlera e provës rrjedh jo vetëm nga vlera logjike por edhe nga besueshmëria e bartësit të provave. Në rastin konkret gjykata besueshmërinë e provave– deklaratën e të akuzuarit, dëshminë e të dëmtuarit si dhe të dëshmitarëve si dhe të provave materiale, ka verifikuar në lidhshmëri me tërësinë e të gjithë provave të cilat i ka pasur në dispozicione në këtë çështje penale.

Pra, teza e akuzës gjendjen faktike e bazon në deklaratën e të dëmtuarit dhe atë të dëshmitarit E. B., zyrtare policore e cila ka punuar në këtë rast në grumbullimin e provave lidhur me marrjen e analizave të hartografisë.

Meqenëse vlerësimi i provave përbëhet nga ajo që gjykata nga përmbajtja e provave nxjerr si konkluzion mbi ekzistimin ose mos ekzistimin e fakteve për vërtetimin e të cilëve është administruar një provë, në rastin konkret ka analizuar deklaratën e të dëmtuarit të dhënë në polici, tek prokurori i shtetit dhe atë të dhënë në shqyrtimin kryesor.

Në fakt, i dëmtuari në deklaratën e dhanë para policisë tri ditë pas rastit, ka deklaruar se nuk i kujtohet saktësisht po diku në ora 16:50 minuta, sa ka dalë nga dera e lokalit, si e ka bërë një apo dy hapa në rrugën, me fytyrë ka qenë i kthyer nga ana e poshtme e Dragashit, ka ndier disa goditje të forta, posaçërisht goditjen e parë nga e cila ka ndier sikur t'i ishte shqyer xhaketa, në vete ka sharë duke menduar se dikush po tallet, është kthyer prapa në të djathtë, nuk ka vërejtur askënd, në të njëjtën moment është kthyer majtas dhe ka vërejtur një person të ri, të gjatë me trup të dobët, me flokë të shkurtra, me xhaketë të lëkurës, mendon se ishte ngjyrë kafe dhe me farmerka. Së bashku me kolegun së pari kanë shkuar në një bastore e aty afër për të shikuar se mos rastësisht aty gjendet personi i dyshuar, por nuk kanë vërejtur asnjë njeri i cili i ngjante të dyshuarit ashtu siç e ka vërejtur. Pastaj kanë shkuar në drejtim të fabrikës „R. T.“ në drejtim të fshatit R. deri te pompa e benzinës „K. P.“ por rrugës nuk kanë vërejtur asnjë person të dyshimtë. Nuk është i sigurt po më së shumti dyshon tek F. Q. edhe pse nuk është i sigurt, dyshon tek ai pasi është i prirë për konflikte dhe ka disa raste të therjeve me thikë. Në deklaratën të dhënë pas dy muaj më datën 25.02.2016, ka deklaruar se është i sigurt që i akuzuari F. Q. është personi i cili e ka therur me thikë, mendon se ai ka pasur qëllim ta mbysë se ajo ka qenë pritje klasike dhe po ta kishte therur vetëm një herë, do të mendonte se ka qenë aksidentalisht, por ai me vetëdije të plotë e ka sulmuar me thikë tri herë. Nuk ka asgjë personalisht me të por ai ka pasur disa raste të therjes me thikë në Dragash dhe për këto raste kanë hapur hetime, përveç për një rast i cili ka ndodhur në gusht 2015, nuk është hapur hetimi për shkak të kërkesës së viktimës dhe prindërit që të mbyllet rasti, asokohe F. i ka thanë që nëse edhe një herë e sulmon atë person do të inicohet procedura, prezentë ishte edhe baba e F. Prandaj mendon se kjo ka qenë arsyeja për sulmin ndaj tij ditën kritike. Kur ka dhënë deklaratën e parë nuk ka përmendur emrin e F. sepse ka pritur nga familjarët e F. që do të vijnë dhe tregojnë keqardhje për rastin, por ata nuk kanë ardhur. Në deklaratën e dhënë pranë prokurorisë duke mbështetur deklaratat e mëhershme ka shtuar se pasi ka ndodhur rasti në shtëpinë e tij ka ardhur babai i F. Q. për të pyetur nëse është e vërtet që F. e ka sulmuar, pra kjo ka ndodhur pasi që F. është parburgosur. Atëherë i ka thënë se F. ia falë për veprimet që i ka bërë por me një kusht që të tregojë se kush e ka përcjellë ditën kritike sepse po ta kishte përcjellë ai vetë do ta shihte dikush. Gjatë shqyrtimit kryesor ka shtuar se ditën kritike i kujtohet se prej shtëpisë ka dalë në ora 13:10 minuta dhe ka shkuar në Dragash përmbi restorantin „Sh.“ diku në mes ora 13:00 – 14:00 ka vërejtur F. në shoqëri me dy shokë, ishte i veshur me farmerka dhe xhaketë ngjyrë kafe. Pas një kohe kur ka dalë nga kafeteria „T.“, tashmë ka filluar të errësohet por kishte ndriçim të mirë prej lokaleve. Përndryshe, meqë me babanë e F. ka raporte të mira që nga koha e gjyshërve, në seancën e datës 16.05.2016 ka dashur t'ia falë F. veprimet si një dhuratë, sepse atë ditë e kishte edhe ditëlindjen, duke shpresuar se kjo falje do të ndikojë tek ai që në të ardhmen nuk do të ketë sjellje të tilla aq më tepër se si zëvendës i komandantit pranë Stacionit Policor në Dragash, ka rolin që të përcjellë sjelljet e qytetarëve në përgjithësi. Nuk parashtron kërkesën pasurore juridike. Sa i përket personit nga fshati G. me emër A., i njëjti është i njohur për vozitje të shpejtë, paguan shumë dënime të komunikacionit dhe këtë e di sepse mban evidencën e tiketave të dënimit në komunikacion, por problem me të nuk ka pasur. E di që ka qenë i

dyshuar për një rast të vjedhjes në fshat por i njëjti është më i ri se F. dhe më i shkurtër, flokët e prera anash, në mes më të gjatë dhe krehura prapa, i dobët por pak më i plotë se F.

Lidhur me faktin se i dëmtuari nuk ka qenë i sigurt për sulmuesin dhe se në fillim nuk ka përmendur emrin e tij, ka dëshmuar dëshmitari M. A., i cili në mes tjerash ka deklaruar se nga kafeteria „T.“ së pari ka dal ai për të shkuar deri te vendi ku e kishte të parkuar veturën dhe pasi është kthyer dhe parkuar para kafeterisë, ka dalë edhe i dëmtuari E. i cili menjëherë i tha se dikush e paska sulmuar me një shufër apo diç të ngjashme, por sulmuesin nuk e ka parë, vetëm ka parë se ka qenë i dobët dhe ka pasur të veshur një xhaketë ngjyrë kafe. Kur e ka pyetur se në çfarë drejtimi ka shkuar, ai i tha se ka shkuar në drejtim të bastorës përballë kafeterisë, bashkë shkuan atje por nuk e panë askënd, pastaj shkuan me një kafeteri tjetër dhe vazhduan deri në internet kafe, mirëpo askush nuk ishte atje, kanë vazhduar me veturë duke lëvizur rreth 20 metër deri në hyrje për Dragash, por pa sukses. Prej njerëzve ka kuptuar që E. po dyshon në F., e të cilin përndryshe personalisht nuk e njeh. Ka pasur edhe shumë ankesa për personin me emër A. për shkak të vozitjes së shpejtë, për këtë ka ditur sepse ka punuar edhe pranë nënstacionit në K., i cili i mbulon disa fshatra përfshirë edhe G.

Në këtë drejtim ka dëshmuar edhe dëshmitari R. O. i cili në mes tjerash ka deklaruar se mbrëmjen kritike ka qenë bashkë me të dëmtuarin dhe kolegun tjetër M. dhe pasi ata dytë janë larguar nga kafeteria, ai ka mbetur edhe pak aty. Prej kolegut Sh. K. ka kuptuar lidhur me rastin mirëpo nuk është përmendur emri i të dyshuarit ashtu që nuk din asgjë rreth sulmuesit meqë edhe nuk ka punuar në këtë rast. Përndryshe kolegu E. asnjëherë nuk ka përmendur se ka ndonjë problem me F.

Edhe dëshmitari Sh. K. i cili ka punuar në këtë raste, ka deklaruar se rreth orës 17:50 deri sa gjendej në shtëpi, ka marrë informata se E. S. është i sulmuar, se është në gjendje kritike dhe gjendet rrugës për në spitalin e Prizrenit. Menjëherë ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe pas një kohe të shkurtër ka thirrur djalin e E. për të pyetur për gjendjen shëndetësore e të atit dhe nëse eventualisht mund të jap ndonjë informacion rreth vendit të saktë ku ka ndodhur rasti dhe për personin e dyshuar. Ka marrë përgjigje se personi i dyshuar është me shtatë të gjatë, i dobët, me xhaketë të lëkurës, mirëpo pa përmendur asnjë emër. Ka dërguar patrullën në teren për identifikimin e personit me karakteristika të përshkruara dhe personi i parë i dyshuar ka qenë një person emrin e të cilit nuk e dinë përveç se është nga fshati G., për të cilin më vonë është verifikuar alibi se në fakt ka qenë në internet kafe. Gjatë bisedës së mëvonshme me të dëmtuarin ka kuptuar se i dyshuari i mundshëm është një djalosh nga R., një lagje ku jeton F. Q., në të cilin ra dyshimi edhe sipas përshkrimit të cilin e ka dhanë i dëmtuari. Kanë tentuar të vërtetojmë alibinë e tij edhe në bazë të faktit se patrulla e policisë ka kontaktuar me të atin e të dyshuarit i cili u ka thanë se F. nuk është në shtëpi, se nuk e dinë ku gjendet por se do ta lajmërojë me telefon dhe se ai do të paraqitet në polici, ashtu që patrulla është larguar dhe në të vërtetë pas një kohe të shkurtër i dyshuari F. është lajmëruar në polici. Prandaj në bazë të të gjithë këtyre rrethanave F. ka qenë i dyshuar. Është e vërtetë se të njëjtin e ka parë të ulur në korridorin e stacionit policor, por nuk i kujtohet se çfarë ka pas të veshur.

Prova tjetër në të cilën mbështetet aktakuza është deklarata e dëshmitares E. B., e cila ka dëshmuar se ka punuar në këtë rast dhe se personi i parë i cili ishte i dyshuar ka qenë një person emrin e të cilit nuk ia di por atë person e ka vërejtur në korridorin e gjykatës. Personi tjetër i dyshuar ka qenë F. Q. të cilin e ka parë pranë stacionit policor në Dragash dhe të cilin e ka marrë në pyetje, i njëjti në fillim kishte statusin e dëshmitarit dhe pas dhënies së deklaratës është lëshuar i lirë. Tre ditë pas rastit ka marrë në pyetje edhe të dëmtuarin E. i cili

ka dhanë përshkrimin e personit duke thanë nuk është 100 % i sigurt, por është i sigurt 70 – 80 % se e ka sulmuar F. Q., pas kësaj ka kërkuar raportin për hyrje -dalje të bisedave telefonike të dyshuarit F. Q. Nga deklaratat e F. Q. në cilësi të dëshmitarit, ka kuptuar se ditën kritike i njëjti ka qenë tek restoranti “M.” në Dragash. Për të vërtetuar këtë fakt ka shikuar incizimet e kamerës mirëpo në ato incizime nuk shihej F. Q. Pastaj sipas tij, në shtëpi ka qenë rreth ora 16:00, ndërsa nga rezultati i hyrje daljeve është konstatuar se ai ka bërë një thirrje që përputhet me vendin nga ka bërë thirrje edhe i dëmtuari, nëse nuk gabon kjo ka qenë diku rreth orës 16:47 minuta. Për sqarim nga operatori mobil “Vala” ka kërkuar analizë për 6 thirrje telefonike nga numri i tij xxx-xxx-xxx, të cilat nuk përputhen me vendin nga janë bërë thirrjet dhe antenat e njëjta dhe thirrja e bërë ditën kritike rreth orës 16:47 minuta, sipas operatorit “Vala” nuk figuron e regjistruar nga antena e njëjtë. Në fakt vendi nga është bërë kjo thirrje është regjistruar nga antena “Dragash G3” dhe përputhet me vendin ku ka qenë edhe viktima, ndërsa F. po të kishte thirrur nga shtëpia, atëherë do të regjistrohej nga antena “Bukiqi G3”. Po ashtu i kujtohet se me rastin e marrjes në pyetje si dëshmitar, i njëjti ka thënë se ditën kritike ka shëtitur qentë në pyll, mirëpo analiza e hartografisë së atij vendi ka treguar se atë territor e përfshin po ashtu antena “Bukiqi G3” dhe kur rreth ora 19:00 policia ka shkuar në shtëpinë e tij, F. nuk ndodhej në shtëpi, i ati e ka thirrur me telefon, e cila thirrje po ashtu është regjistruar në antenën “Bukiqi G3”. Pra në bazë të këtyre provave, faktit se F. Q. ka pasur disa raste në polici, si dhe në bazë të deklaratës së të dëmtuarit, ka konsideruar se i dyshuari është F. Q.

Duke patur parasysh që vlerësimi i provave përbëhet nga ajo që gjykata nga përbërja e tyre nxjerr konkluzion mbi ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve për vërtetimin e të cilëve edhe është administruar prova, si dhe të vërtetohet ekzistimi i veprës penale dhe kryesi i sajë si dhe të gjithë rrethanat relevante, gjykata ka analizuar rastin konkret dhe në bazë të gjitha provave të administruara ka nxjerr konkluzion se në veprimet të akuzuarit F. Q. nuk formohen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Pra, gjykata deklaratën e të dëmtuarit, i cili është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit ka analizuar si provë dhe besueshmërinë e sajë ka vlerësuar në bazë të rrethanave të rastit dhe të situatës me të cilën është gjetur i njëjti, si dhe mundësin e perceptimit të kryesit, pranë kësaj duke pasur parasysh se vlera e perceptimit varet nga një varg dhe gërshetim i rrethanave për të cilat nuk është i vetëdijshëm as ai vetë, para të gjithash për kushtet në të cilat ka perceptuar ngjarjen, karakteristikat e jashtme si dhe ato të brendshme dhe kushtet e tjera të cilat ndikojnë në fuqinë e perceptimit. Duke pasur parasysh rastin konkret si dhe faktet jokontestuese se i dëmtuari ditën kritike kah ora 13:00 – 14:00 ka parë të akuzuarin diku në Dragash bashkë me disa shokë, se e ka njohur mirë të akuzuarin dhe se ka vërejtur se me çfarë rroba ka qenë i veshur në momentin kur e ka parë – xhaketa e lëkurës, farmerka të cilat na udhëzojnë në atë se gjatë perceptimit janë përzier ato çka i kishte në mendjen e tij me atë se çfarë ka parë në të vërtetë, kur pranë kësaj i shtojmë edhe rrethanat e jashtme se ka qenë errësirë me pak dritë nga lokalet përreth, fakti se i dëmtuari ka dal nga kafeteria ku ka qëndruar me shokë duke pirë bira si dhe koncentrimi i tij për të perceptuar-vërejtur se çfarë ka mund të ndodhë në momentin kritik. Kur të gjithë këtyre i shtojmë edhe deklaratat e të dëmtuarit të dhëna në polici menjëherë pas rastit, pastaj ajo e thënë dy muaj pas rastit në Prokurori si dhe në shqyrtimin kryesor, sipas mendimit të gjykatës nuk kanë qenë të bindshme për arsye se në fillim i dëmtuari nuk ka përmendur asnjë emër, ka dhënë një përshkrim i cili mund të përshtatet shumë personave të rinj, më vonë ka deklaruar se i dyshimti i mundshëm mund të jetë një djalosh nga lagja R. ku iu kujtua se aty po jetuaka F. Q., që na shpie në pyetje se në këtë lagje athua nuk paska djem të rinj të tjetër përveç F. Q., si dhe ka dhënë shumë shkaqe të tjera jo të bindshme për të arsyetuar në njëfarë mënyrë veprimet e të akuzuarit F. duke ia falur

ato veprime vetëm e vetëm me një kushte që ai t'i thoshte se kush e kishte përcjellë të dëmtuarin meqenëse po ta kishte përcjellë vetë F. dikush do ta shihte, pastaj nuk ka qenë i sigurt 100 % por vetëm 70 -80% se F. qenka i dyshuari i mundshëm dhe ai paska pritur prej familjes së F. që të kërkojnë falje prej tij për këtë rast. E gjithë kjo na udhëzon se në fakt as vet i dëmtuari nuk ka qenë i sigurt se cili ka qenë personi i cili e ka sulmuar. Nëse këtu përmendim edhe tërë procedurën e zhvilluar pranë dy stacioneve të policisë, në Dragash dhe Prizren, në grumbullimin e provave, dyshimin e tyre për F. vetëm e vetëm sepse ai ka qenë i njohur për policinë për disa vepra të tjera inkriminues në kohën kur ka qenë i mituri, nuk ka qenë e mjaftueshme që ta bind gjykatën se i akuzuari F. Q. është kryesi i veprës penale për të cilën është akuzuar.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitares E. B., gjykata konsideron se e njëjta nuk ishte e bindshme në atë drejtim se analiza e rezultateve të hartografisë dhe të bisedave telefonike për të ka qenë e mjaftueshme për të krijuar bindje se i akuzuari është kryesi i veprës, sepse ajo nuk ka sqaruar në mënyrë profesionale se në momentin kritik i akuzuari ka qenë në vendin i cili përputhen me vendin ku ka qenë edhe i dëmtuari, e të cilat vende i mbulon antena e njëjtë, kjo duke pasur parasysh se në momentin kritik nuk është vërtetuar vendi se ku ka qenë i akuzuari dhe i njëjti në çdo deklaratë ka treguar se ka shëtitur qentë në pyll dhe se ka qenë afër shtëpisë së tij në momentin kur ka pranuar thirrjen telefonike nga babai. Parashtrohet pyetja se a mund të përcaktohen saktë kufijtë dhe domeni i atyre antenave që ka përmendur në deklaratën e saj dhe a mund të qëndron pohimi i dëshmitare se F. Q. është i dyshuari i mundshëm vetëm për arsye se i njëjti për policinë ka qenë i njohur për disa konflikte, duke pasur parasysh se në atë kohë kanë pasur dyshim edhe për një person tjetër të mundshëm, alibinë e të cilit kanë pranuar që në fillim të hetimeve.

Nga arsyet e cekura gjykata vendosi si në shqiptimin e këtij aktgjykimit.

Konformë nenit 454 të KPPK është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Në bazë të nenit 463 par. 3 i dëmtuari udhëzohet në kontestin e rregullt civil, për realizimin e kërkesës pronësoro juridike.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.81/2016 të datës 06.12.2016

Sekretarja juridike
Valdete Zurnaxhiu

Kryetari i trupit gjykues
Raima Elezi

KËSHILLA JURIDIKE : pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite nëpërmjet të kësaj gjykate Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Përkthyesja gjyqësore Asnije Berisha